Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/34
Datë: 22.02.2022

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë nr. 09/2019, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 22.02.2022 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet** institucioni "Creative Education", me adresë: Rr. Henry Dynan A4-Podrum, si dhe Rr. Gazmend Zajmi Nr. 15-1, Prishtinë, Republika e Kosovë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 22.02.2022 deri 21.02.2025, për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar këto kualifikime:

   1.1 **Kurse të Gjuhës Gjermane, niveli A1 deri në B1,** institucioni mund të realizojë procesin e aftësimit deri në dhjet (10) kandidatë brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në 60 grupe.

   1.2 **Kurse Të Gjuhës Angleze, niveli A1 deri në B2,** institucioni mund të realizojë procesin e aftësimit deri në tetë (8) kandidatë brenda një grupi dhe sipas niveli A1 - 24 grupe, niveli A2 - 24 grupe, niveli B1 - 12 grupe, dhe niveli B2 - 10 grupe gjatë një viti.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së "Creative Education", për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Creative Education, dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK